

## Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	Mikroekonomia I
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I-rë
Numri i orëve në javë:	3
Vlera në kredi – ECTS:	8
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Dr. Florentina Xhelili Krasniqi
Detajet kontaktuese:	florentina.xhelili@uni-pr.edu
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	<p>Kjo lëndë do t'i njoftojë studentët me bazat e teorisë mikroekonomike, si degë e ekonomisë. Fokusi do të jetë mbi zgjedhjet dhe vendimet të cilat i marrin individët dhe ndërmarrjet në kushte të resurseve të kufizuara. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet tregut dhe aspekteve të lidhura me të, sistemin e çmimeve, dhe alokimit (apo shpërndarjen) të resurseve. Përcaktimi i çmimit në kushte të konkurrencës së plotë dhe asaj të kufizuar është një ndër elementet qendrore të lëndës. Në fund, lënda do të koncentrohet në shpërndarjen e të ardhurave dhe efektet e sektorit publik/shtetit dhe efektet e tij në ekonomi.</p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<p>Ky modul do t'i pajisë studentët me njohuri hyrëse mbi çështjet bazike mikroekonomike, lidhur me pamjaftueshmërinë, zgjidhjen, çmimet dhe alokimin e resurseve si dhe njohjen me "mënyrën ekonomike të të menduarit".</p>
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p>Me kompletimin e këtij moduli, studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• kuptojnë natyrën e problemeve ekonomike dhe si sistemi i tregut përdorë çmimet për të alokuar resurset (burimet);</li><li>• shpjegojnë se si bashkëveprojnë akterët e ndryshëm në procesin e prodhimit dhe konsumit dhe si ndërhyjnë qeveria për të promovuar mirëqenien ekonomike;</li><li>• vlerësojnë efektet e dështimit të tregut dhe të informatave joeficiente në marrjen e vendimeve</li></ul>

	<p>nga firmat, individët, familjet dhe agjencionet;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• jenë në gjendje të aplikojnë analizën ekonomike në tregje të ndryshme në aspektin mikroekonomik.</li> </ul> <p>Ky modul, po ashtu, duhet të zhvillojë tek studentët edhe këto shkathtësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkathtësitë e zgjidhjes së problemeve;</li> <li>• Shkathtësitë e komunikimit dhe prezantimit,</li> <li>• Shkathtësitë e punës në ekip,</li> <li>• Shkathtësitë e të shkruarit,</li> <li>• Shkathtësitë e interpretimit të numrave, tabelave dhe grafikëve.</li> </ul>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligjërata interaktive;</li> <li>• Pune grupore rreth çështjeve specifike (analiza dhe diskutime);</li> <li>• Teste vetëvlerësimi.</li> </ul>
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kollokviumi i parë: 45%</li> <li>• Kollokviumi i dytë: 45%</li> <li>• Pjesëmarrja aktive (ligjërata): 5%</li> <li>• Prezantimet e punimeve (ushtrime): 10%</li> <li>• Provimi final</li> </ul>
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ahmet Maçellari, Sulo Hadëri, Dhori Kule, Stefan Qirici, "Hyrje në Ekonomi", Shtëpia Botuese "PEGI" Tiranë.</li> <li>• N. Gregory Mankiw, Principles of Microeconomics (libër i përkthyer në gjuhën shqipe)</li> </ul>
<b>Literatura shtesë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Florentina Xhelili Krasniqi, Strukturat e tregut, 2018.</li> <li>• Paul A. Samuelson &amp; William D. Nordhaus, "Economics" (libër i përkthyer në gjuhën shqipe).</li> <li>• John Sloman, "Economics", Botimi i shtatë.</li> <li>• Wiliam Boyes &amp; Michael Melvi, "Microeconomics", Botimi i dhjetë.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Artikuj nga interneti, revistat dhe shtypi.</li> </ul>
<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<i>Java e parë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Syllabusi</li> </ul>
<i>Java e dytë:</i>	<b>Një vështrim i përgjithshëm mbi shkencën ekonomike</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Kuptimi i ekonomiksit</li> <li>▪ Kufiri i mundësive të prodhimit dhe kostoja oportune</li> <li>▪ Pamje e përgjithshme e ekonomisë së tregut</li> <li>▪ Përse është e nevojshme njohja e Ekonomiksit</li> <li>▪ Metodologjia e shkencës ekonomike</li> </ul>
<i>Java e tretë:</i>	<b>Kërkesa, oferta dhe ekuilibri i tregut</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Kërkesa dhe kurba e kërkesës</li> <li>▪ Oferta dhe kurba e ofertës</li> <li>▪ Ekuilibri i tregut dhe Disekuilibri</li> </ul>
<i>Java e katërt:</i>	<b>Elasticiteti i kërkesës dhe ofertës</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Elasticiteti i kërkesës lidhur me çmimin dhe faktorët që përcaktojnë elasticitetin e çmimit</li> <li>▪ Lloje të tjera të elasticitetit</li> </ul>
<i>Java e pestë:</i>	<b>Zgjedhja konsumatore dhe kërkesa</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Zgjedhja racionale dhe vendimet e konsumatorit</li> <li>▪ Dobia marxhinale dhe kërkesa e konsumatorit Zgjedhja konsumatore dhe ligji i kërkesës</li> <li>▪ Analiza ordinaliste e zgjedhjes konsumatore</li> </ul>
<i>Java e gjashtë:</i>	<b>Firma dhe objektivat e saj</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Llojet e firmave</li> <li>▪ Rrugët e rritjes së kapitalit nga firmat</li> <li>▪ Kontabiliteti i firmës. Bilanci dhe pasqyra e rezultatit financiar.</li> </ul>
<i>Java e shtatë:</i>	<b>Kollokviumi i parë</b>
<i>Java e tetë:</i>	<b>Teoria e prodhimit dhe produktit marxhinal</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Funkzioni i prodhimit në periudha afatshkurtra</li> <li>▪ Ligji i të ardhurave zbritëse</li> <li>▪ Të ardhurat e shkallës, faktori kohë dhe ndryshimet në teknologji</li> <li>▪ Funkzioni i prodhimit në periudha afatgjata</li> </ul>

<b>Java e nëntë:</b>	<b>Kostoja</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Kostot në periudha afatshkurtra</li> <li>▪ Kostoja në periudha afatgjata</li> </ul>
<b>Java e dhjetë:</b>	<b>Oferta dhe përcaktimi i çmimeve në konkurrencë të plotë</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Tiparet e tregut konkurrencial dhe kurba e kërkesës së firmës.</li> <li>▪ Vendimet dhe oferta e firmës në një periudhë afatshkurtër</li> <li>▪ Sjellja e firmës dhe e degës në periudha afatgjata</li> <li>▪ Konkurrenca e plotë dhe efiçenca ekonomike</li> </ul>
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	<b>Monopoli</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Monopoli dhe tiparet e tij.</li> <li>▪ Kurba e kërkesës dhe maksimizimi i fitimit në firmën monopol</li> <li>▪ Efiçenca në kushtet e monopolit dhe kritika e tij</li> <li>▪ Diskriminimi i çmimeve në kushtet e monopolit.</li> <li>▪ Politikat shtetërore për kontrollin e monopolit.</li> </ul>
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	<b>Forma të tjera të konkurrencës jo të plotë.</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Tiparet e konkurrencës monopolistike</li> <li>▪ Maksimizimi i fitimit për firmën në konkurrencë monopolistike</li> <li>▪ Oligopoli, llojet dhe baza e ekzistencës së tij</li> <li>▪ Modele të oligopolit.</li> </ul>
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	<b>Shpërndarja e të ardhurave dhe tregu i faktorëve të prodhimit</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Bazat teorike të shpërndarjes së të ardhurave</li> <li>▪ Paga si çmim i faktorit punë , Renta si çmim i tokës dhe Interesi si çmim i kapitalit</li> </ul>
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	<b>Spektori publik</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përse është e nevojshme ndërhyrja e shtetit në ekonomi</li> <li>▪ Spektori publik dhe përmasat e tij</li> <li>▪ Financimi i sektorit publik dhe Zgjedhja publike</li> </ul>
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	<b>Kollokviumi i dytë</b>

<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>
<p>Studentët dhe fakulteti kanë përgjegjësi për sigurimin e një ambient të përshtatshëm për mësim. Studentët duhet të respektojnë rregullat e mirësjelljes gjatë ligjëratave dhe provimeve dhe në komunikim me stafin akademik</p>